LIGJ
Nr.9657, datë 11.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE ARTIGIANCASSA SPA PËR PROGRAMIN "RISTRUKTURIMI DHE FUQIZIMI I SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN NË SISTEMIN E BALLKANIT: FUQIZIMI I AFTËSIVE TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMI I KONTROLLIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa SpA për programin "Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5165, datë 20.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

F.ROT./AID-06/010/00

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR PREJ MINISTRISË SË FINANCAVE DHE ARTIGIANCASSA S.P.A PËR SHUMËN DERI NË 51.494.303,00 EURO "PROGRAMI PËR RISTRUKTURIMIN DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR PËR INTEGRIMIN NË SISTEMIN E BALLKANIT: FUQIZIMI I AFTËSIVE TË TRANSMETIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË KONTROLLIT"

- Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje referuar si "Huamarrësi"), nga njëra anë, dhe

- Artigiancassa S.P.A., Cassa per il Credito alle Imprese Artigiane S.p.A., Gruppo Bancario BNL, e listuar në regjistrin e bankave, me kapital aksionar prej 35.000.000,00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, e regjistruar në regjistrin e shoqërive, me kod fiskal nr.01158450583 dhe me TVSH nr.00968081000 (këtu e tutje referuar si "Artigiancassa"), si administrator, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Republikës së Italisë, i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi, të krijuar në përputhje me nenin 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977, dhe më tej referuar ne nenin 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga Z. ..., në anën tjetër,

(Artigiancassa dhe Huamarrësi, së bashku, këtu e tutje referuar si "Palët")
kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje financiare.

Neni 1
Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat përkatëse, termat e mposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- "Njohja e borxhit" do të thotë deklarimi që i referohet nenit 10, sipas të cilit Huamarrësi merr përsipër të shlyejë në favor të Artigiancassa-s kapitalin plus interesin lidhur me huanë e butë.
- "Banka Agjente" do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), i cili do të përfshihet në këto aktivitete:
- kontroll të dokumentacionit kontraktues;
- veprimet disbursuese;
- veprime të pagesave;
- "Marrëveshje" do të thotë Marrëveshja financiare aktuale, hyrja dhe shtojcat përkatëse që formojnë pjesë përbërëse.
- "Banka Agjente Shqiptare" do të thotë banka e caktuar nga Huamarrësi si banka korresponduese e Artigiancassa-s, e cila vepron si bankë agjente për qëllime të kësaj Marrëveshje.
- "OST" do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit Shqiptar.
- "Huamarrës" do të thotë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë që ka firmosur këtë Marrëveshjeje.
- "Autoriteti kompetent i Huamarrësit" nënkupton Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.
- "Dokumentacioni kontraktues" do të thotë dokumentacioni që i referohet kontratës/kontratave të furnizimit (p.sh.: faturat, llogaritë e ngarkesave, listat e paketimeve, punimet në proces).
- "Periudha e shtyrjes së afatit" do të thotë periudha që zgjat 228 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë.
- "Autoritetet kompetente italiane" do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë njësi kompetente tjetër e Republikës Italiane, e caktuar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.
- "MAE/DGCS" do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim.
- "PIU/NjZP-OST" do të thotë njësia e zbatimit të projektit, e krijuar pranë OST-së, veprimtaria e së cilës është përshkruar në shtojcën 2 të Marrëveshjes për programin në fjalë.
- "Program" do të thotë projekti që lidhet me programin për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit; fuqizimin e aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit, i miratuar në bazë të Marrëveshjes qeveritare nga Qeveria e Republikës së Italisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, financuar pjesërisht në kuptimin e huasë së butë.
- "Kërkesa e datës së disbursimit" do të thotë datën e mbërritjes në Artigiancassa të kërkesës së disbursimit, siguruar nga eksportuesi italian në formularin e shtojcës B.
- "Huaja e butë" do të thotë financimi që Artigiancassa, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, do të akordojë në termat dhe kushtet e ofruara nga neni 3 i kësaj Marrëveshjeje.
- "Kontrata/kontratat e furnizimeve" do të thotë kontrata/kontratat tregtare që lidhen me furnizimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve nga eksportuesit italianë tek importuesit shqiptarë në Shqipëri, që kanë të bëjnë me realizimin e programit.

Neni 2
Hyrje

2.1 Në kuptim të marrëveshjes së njohur si "Marrëveshje qeveritare" (në vijim, referuar si "Marrëveshja qeveritare"), e nënshkruar më …. ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Qeverisë së Republikës Italiane të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin përmes një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 51.494.303,00

(pesëdhjetë e një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e tre) euro;

2.2 Në kuptim të kësaj Marrëveshjeje, Palët kanë si qëllim: (i) të zbatojnë financimet që lidhen me huanë e butë të përcaktuar ne nenin 8 të Marrëveshjes qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës së Italisë, në bazë të propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr.49679, datë 10 maj 2006 ka autorizuar Artigiancassa t'i akordojë Huamarrësit një hua të butë në termat dhe kushtet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si "Huaja e butë") për qëllime të financimit të programit.

Neni 3

Huaja e butë

3.1 Artigiancassa i akordon Huamarrësit dhe Huamarrësi nga kjo pranon huanë e butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: maksimumi deri në 51.494.303,00 (pesëdhjetë e një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e tre) euro.

Kohëzgjatja: 39 vjet.

Shlyerja: 40 (dyzet) këste të principalit të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshëm 228 (dyqind e njëzet e tetë) muaj prej datës së disbursimit të parë.

Norma e interesit: nominale 0.00% në vit (zero pike zero për qind).

Qëllimi i kredisë: Programi për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit; fuqizimin e aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit.

3.2 Shuma maksimale e përmendur në këtë Marrëveshje prej 51.494.303,00 (pesëdhjetë e një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e tre) euro duhet të sigurohet si tavan. Shuma reale do të rezultojë nga sasia totale e kontratave të furnizimit të alokuar si hua e butë.

Në rast se shuma reale do të jetë më e vogël se ajo e përmendur, shuma e mbetur e papërfshirë në shumën totale të kontratave të furnizimit të alokuar nga huaja e butë nuk do të konsiderohet si pjesë e huasë së butë.

3.3 Huaja e butë do të ketë si objektiv:

- të pajisë OST-në me Qendrën e Dispeçerisë dhe të Telekontrollit (QDT);
- t'i japë mundësi OST-së të bëjë pjesë zyrtarisht në tregun elektrik të rajonit, si anëtar efektiv i "Bashkimit për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike" (UTCE) të zonës 2: Europa Juglindore;
- të përmirësojë qëndrueshmërinë e sistemit elektrik shqiptar.

3.4 Huaja e butë do të përdoret për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 35% (tridhjetë e pesë) e shumës referuar huasë së butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importimit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim.

Kontratat e furnizimit do të jenë në euro.

3.5 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

3.6 Kontratat e furnizimit që lidhen me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen përmes ofertave publike të rezervuara për kompanitë italiane mbi bazën e procedurave të ofruara në "Manualin e Procedurave" (të miratuara nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) lidhur me: shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit Europian në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta".

3.7 Huaja e butë do të bëhet e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes ambasadës italiane - ambasada/ zyra e bashkëpunimit:

i) një deklaratë nga autoriteti kompetent i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas rregullit në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje;

ii) caktimin me shkrim nga një autoritet kompetent i Huamarrësit i personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga ambasada italiane në Tiranë–ambasada/zyra e bashkëpunimit), kërkesa për financim e kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A) dhe njohjen e borxhit në formularin e shtojcës C) referuar nenit 10 më poshtë. Një përcaktim i tillë duhet të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë "modelin" e përditësuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka) duhet të transmetohet në kohë nga Huamarrësi tek Artigiancassa;

iii) një deklaratë nga autoriteti kompetent i Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me caktimin e Bankës Agjente Shqiptare, duke i kërkuar autoritetit të Bankës Agjente Shqiptare të veprojë në emër dhe për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Artigiancassa, pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura që t'i kenë plotësuar kërkesat e saj, do të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare Agjente me anë të letrës ose faksit, i cili pastaj duhet të pasohet nga një letër e konfirmuar, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi.

Neni 5

Afatet për disbursimin e huasë së butë

5.1 Periudha e disbursimit të huasë së butë do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë. Një periudhë e tillë mund të zgjatet nga Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk janë dakord për një shtyrje të tillë dhe të kenë njoftuar me shkrim Artigiancassa-n së paku 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të datës së periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, Artigiancassa, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huasë së butë

6.1 Huaja e butë mund të përdoret nga Huamarrësi pasi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) autorizimin e dhënë nga autoritetet kompetente italiane për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit tek huaja e butë;

ii) rezultate të kënaqshme nga kontrolli i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2 (i) më poshtë.

iii) marrjen nga Artigiancassa të kërkesës së financimit të kontratës së furnizimit të parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Pas marrjes së autorizimit të përmendur në pikën 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të kryejë menjëherë veprimet si më poshtë:

i) të bëjë kontrollin mbi bazën e kërkesës, parashikuar nga autoriteti kompetent italian mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/kompanitë italiane, nëse ka, të përfshirë me organizatat lokale dhe mbi kontratën/kontratat e furnizimit. Në lidhje me kontratën/kontratat e furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato të jenë në përputhje me termat dhe kushtet e huasë së butë dhe që të jenë mjaftueshmërisht të detajuara përsa i përket zërave të kostove/çmimeve, në mënyrë që të lejojë kontrollet sipas nenit 8.2.

ii) të njoftojë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare Agjente për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1 (i) më sipër dhe t'i kërkojë Bankës Shqiptare të nisë kërkesën e parashikuar sipas nenit 7.1

6.3 Rezultatet e suksesshme të kontrollit të bërë nga Artigiancassa sipas nenit të mësipërm 6.2 (i), do të sjellin alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit tek huaja e butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve të vendosura sipas nenit 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me letër ose teleks/faks Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankën Shqiptare Agjente, OST-në, eksportuesin italian dhe MAE/DGCS për alokimin, si dhe për financimin e kontratës/kontratave së furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultatit të kënaqshëm të kontrollit sipas nenit 6.2 (i), Banka Agjente Shqiptare do t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit, të nevojshme për pagesat e parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkese, e cila do të jetë në formularin e shtojcës A, Banka Agjente Shqiptare do të vërtetojë se kontrata e furnizimit është e pranueshme për t'u financuar dhe do të ndërmarrë t'i rimbursojë Artigiancassa-s sasinë e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit e parashikuar në nenin 7.1 do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga Artigiancassa, parashikuar në nenin 6.4 më sipër ose afatin (nëse ka) e parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, Artigiancassa do të shqyrtojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit, alokuar për huanë e butë.

Neni 8

Procedura e disbursimit

8.1 Eksportuesi italian do t'i dorëzojë dokumentacionin kontraktual Artigiancassa-s dhe do të kërkojë disbursimin në përputhje me kontratën e furnizimit të sasisë përkatëse në formularin e shtojcës B. Artigiancassa do të informojë menjëherë Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, Bankën Agjente Shqiptare dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me anë të mesazhit me telefaks që dokumentacioni kontraktual është paraqitur, duke specifikuar kërkesën e datës së disbursimit. Artigiancassa do të rishikojë menjëherë dokumentacionin kontraktual. Ky rishikim do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

8.2 Në rast se rezultati i rishikimit është i suksesshëm, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas datës së disbursimit, Artigiancassa do t'i postojë me rrugë diplomatike një kopje origjinale të dokumentacionit kontraktual Bankës Agjente Shqiptare. Kjo e fundit, nëse nuk vëren mospërputhje, do t'i dërgojë Artigiancassa-s autorizimin e disbursimit në formularin e shtojcës C, i cili duhet të bazohet në reagimin pozitiv të dhënë nga OST-ja për Bankën Agjente Shqiptare brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Nëse brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit, Banka Agjente Shqiptare dështon në lëshimin e autorizimit të disbursimit për Artigiancassa-n, kjo e fundit menjëherë pas përfundimit të një periudhe prej 7 (shtatë) ditësh pas skadimit të periudhës paraprake, do të konsiderohet e autorizuar në mënyrë absolute për livrimin e fondeve eksportuesit italianë.

8.3 Në rast se Artigiancassa vëren mospërputhje në dokumentacionin kontraktual, do të informojë me anë të telefaksit eksportuesin italian dhe Bankën Agjente Shqiptare brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas kërkesës së datës së disbursimit. Eksportuesi italian duhet t'i dërgojë dokumentet e korrigjuara Artigiancassa-s brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike pas datës së njoftimit të dërguara nga Artigiancassa. Artigiancassa do t'i postojë menjëherë me rrugë diplomatike dokumentet origjinale të korrigjuara Bankës Agjente Shqiptare. Që këtej e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenin 8.2.

8.4 Në rast se Banka Agjente Shqiptare vëren mospërputhje në dokumentacionin kontraktual dhe/ose OST-ja siguron një reagim negativ, Banka Agjente Shqiptare duhet të informojë Artigiancassa për atë qëllim brenda 27 (njëzet e shtatë) ditësh pas kërkesës së datës së disbursimit, duke u kujdesur t'i kthejë Artigiancassa-s me rrugë diplomatike origjinalin e dokumentacionit kontraktual. Me marrjen e këtij njoftimi, Artigiancassa do të informojë menjëherë eksportuesin italian në lidhje me mospërputhjet dhe/ose pretendimet e OST-së, me kërkesën e dokumenteve të korrigjuara. Që këtej e tutje do të zbatohet procedura e përmendur në nenet 8.3 dhe më pas 8.2. Në rast mosmarrëveshjesh, çështja do të rregullohet sipas asaj çfarë është parashikuar në kontratën e furnizimit. Pagesa do të

ekzekutohet vetëm pas zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pas së cilës do të zbatohet procedura e parashikuar në nenin 8.2.

8.5 Artigiancassa do të bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë dhe do të marrë nga ky eksportues/këta eksportues italianë faturën e lëshimit, të parashikuar në shtojcën D në dy origjinale, njëri prej të cilëve do t'i ridërgohet Bankës Agjente Shqiptare.

8.6 Pas çdo pagese, në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë me shkrim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare një program ripagese të sasisë së disbursuar, duke cilësuar datat e maturuara në lidhje me të, në përputhje me nenin 9 më poshtë. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të konfirmojë me shkrim pranimin nga ana e saj të programit të mësipërm të ripagimit.

Neni 9
Shlyerja e huasë së butë

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të ripaguhet në përputhje me pasqyrën e shlyerjeve në 40 (dyzet) këste të shtyra, të njëpasnjëshme, të barabarta, të ndara në çdo gjashtë muaj (më poshtë të quajtura si kështet e principalit), i pari i të cilëve do të bëhet i pagueshëm 228 (dyqind e njëzet e tetë) muaj nga disbursimi i parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Agjente Shqiptare pasqyrën e shlyerjeve në përputhje me nenin 8.6.

9.2 Për kështet e principalit të kredituara efektivisht, të papaguara, interesi i vonesës do të llogaritet me një normë vjetore prej 0.00% në vit (zero pikë zero për qind).

Banka Agjente Shqiptare, në emër të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, merr përsipër të bëjë pa vonesë të gjitha pagesat dhe shlyerjet që rezultojnë nga kjo Marrëveshje, si dhe gjithashtu nga njohja e borxhit, në datën e përcaktuar aktuale, për shumën koresponduese në euro, në favor të Artigiancassa-s ose personit/personave të autorizuar nga ajo. Shuma të tilla do të kreditohen pa zbritjet e ndonjë banke dhe/ose të normës së shkëmbimit dhe/ose taksave dhe pa lajmërim të saj nga Artigiancassa ose personat e autorizuar prej saj.

Neni 10
Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së skadimit të disbursimit të fundit të huasë së butë të shprehur në nenin 5.1, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do t'i dorëzojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar siç duhet dhe të sigluar në çdo faqe në formularin e shtojcës E.

10.2 Pasqyra e shlyerjeve të shprehura në njohjen e borxhit do të kompletohet duke mbledhur të gjitha kështet e principalit dhe të interesit ende të pamaturuara dhe kështet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit, të parashikuara në pasqyrën e shlyerjeve përkatëse për çdo disbursim, në përputhje me kushtet e nenit 8.6.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë në njohjen e borxhit pagesat e pricipalit dhe të interesit së bashku me kështet e mundshme, të cilat janë maturuar por nuk janë paguar. Sapo të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit të jenë bërë, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të nënshkruar siç duhet e të vërtetuar.

Neni 11
Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të është i pavarur, absolut i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12
Pengesat dhe forcat madhore

12.1 Në rast të pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si luftë,

përmbytje, zjarr, tërmet, konflikte pune dhe greva, veprime të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura të transportit, punës apo rasteve të tjera) do të zbatohen kushtet e specifikuara në Marrëveshjen Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e autoritetit kompetent italian lidhur me aktivitetet e programit.

Neni 13
Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të huasë së butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar çdo kërkesë disbursimi sipas nenit 8, në rast se ndodh mospagesa ose në rast se ndodh mospagesë sipas çdo huaje tjetër të butë dhënë nga Qeveria e Republikës Italiane Qeverisë ose bankës qendrore apo agjencive shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të datës 9 shkurt 1979 dhe nenit 6 të ligjit nr.49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës Italiane, siç është amenduar herë pas here. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe Bankën Agjente Shqiptare në lidhje me këtë pezullim.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë disbursimi të parashikuar në nenin 8 në rast se shumat korresponduese janë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane. Artigiancassa nuk do të konsiderohet përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shumat që do të disbursohen sipas huasë së butë nuk do të vihen në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 14
Kamatëvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arsye çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat e maturuara për principalin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa-s, mbi shumën e përmendur, kamatëvonesa, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Kjo kamatëvonesë që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë. Kjo kamatëvonesë nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike, menjëherë vijuese, nga data fillestare e detyrimit, dhe më pas, me një normë prej 2,5% (dy pikë pesë për qind) deri në datën e kreditimit ne favor të Artigiancassa-s. Ky i dyti do të përditësohet nga autoritetet kompetente italiane.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e kamatëvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se norma e referencës se interesit tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë aktuale ose e ardhshme, e cila mund të jetë e pagueshme në Shqipëri për çfarëdolloj arsyeje në lidhje me këtë Marrëveshje dhe njohjen e borxhit, do të përballohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë e pagueshme në Itali në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaron se do të përdorë statusin e taksës, të parashikuar në nenin 19 të dekretit të Presidentit të Republikës N.601 i datës 29 shtator 1973, siç është amenduar herë pas here.

Neni 16
Ligji rregullues

16.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë paqësore çdo mosmarrëveshje që rrjedh prej interpretimit dhe/ose performancës së Marrëveshjes.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në ndonjë zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe kohore të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse dhe kjo përpjekje do të dështonte ose (nëse përpjekja është bërë) nuk do të jepte rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet e ngritura prej ose në lidhje me marrëveshjen do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi prej tre gjyqtarësh arbitrazhi:

- një gjyqtar arbitrazhi, i caktuar nga Huamarrësi;
- një gjyqtar arbitrazhi , i caktuar nga Artigiancassa;
- gjyqtari i tretë i arbitrazhit do të caktohet nga arbitrat e lartpërmendur ose në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, nga Kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.3 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk caktojnë gjyqtarët e tyre të arbitrazhit brenda 30 (tridhjetë) ditësh prej kërkesës së palës tjetër, ky gjyqtar arbitrazhi do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës Italiane, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja Palët, pa ndonjë mundësi apelimi.

17.6 Asnjë mosmarrëveshje ose debat që mund të ngrihet ndërmjet palëve në lidhje me këtë, nuk do të pezullojë detyrimet e huamarrësit për të paguar në datën e përcaktuar të rënë dakord, të gjitha shumat e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshje dhe në veçanti të gjitha shumat që rezultojnë prej pasqyrës së shlyerjeve të shprehura në nenin 8 më sipër dhe prej njohjes së borxhit që lidhet me të.

Neni 18
Njoftimet

18.1 Njoftimet për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të adresohen si më poshtë:

Ministria e Financave: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" – Tirana – Albania.
Tel: +355 (4) 250264 – Fax: +355 (4) 228494

Artigiancassa SPA: Via Crescenzo Del Monte "% - Rome – Italy Nucleo Operativo Lex N:49/1987
Tel Zyrë: +39-06-5845414/509; Fax +39-06/5845466

OST: ...

Banka Agjente Shqiptare: Adresa do të sigurohet përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes në fjalë.

Neni 19
Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në tre origjinale në gjuhën angleze. Artigiancassa ruan dy origjinale dhe Huamarrësi ruan një origjinal.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave	ARTIGIANCASSA S.p.A
Nënshkruar në ….. më…….	Nënshkruar në ….. më……

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT

SHTOJCA A

Nga : ..... (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)
Për : Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshja financiare për……..... (….....) euro, e nënshkruar nga, në ……më …….dhe nga Artigiancassa në …….më ……

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, do të donim t'ju informonim se kontrata e furnizimit, këtu, bashkëngjitur, nr…… datë…… midis …….. dhe ……. lidhur me …….. (programin/projektin), është e pranueshme për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej euro …….. (……..), e cila i korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për ……..(eksportuesi italian), që ju do të duhet të kryeni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumenteve kontraktuale, si dhe dy origjinale të dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar.

Ne konfirmojmë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ndërmerr pa kushte dhe në formë të parevokueshme të ripaguajë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e eksportuesit italian, sipas termave dhe kushteve të parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e fundit e përfundimit të disbursimit të huasë së butë parashtruar në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të dorëzojë një njohje borxhi për shumën e principalit që i korrespondon shumës totale të gjithë disbursimit të bërë sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo "njohje e borxhit" do të jetë sipas formularit në shtojcën C të Marrëveshjes financiare.

Me respekt,

Datë: …….....

…….....
Nënshkrimi

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

SHTOJCA B

Nga: ……(Eksportuesi italian)
Për : Artigiancassa S.p.A.
Për dijeni: Banka Agjente Shqiptare

Marrëveshja financiare për…… (…. ...) euro, nënshkruar nga …… në ……më …….dhe nga Artigiancassa S.p.A., në …….më ……

Të nderuar zotërinj

Duke iu referuar kontratës së furnizimit, nr. ……..datë …….mes nesh dhe …….(importues) për shumën prej …… (…. ...) euro lidhur me ……(programin /projektin), ne ju dërgojmë dokumentet kontraktuale që vijojnë:

……. …….
……. …….
……. …….
……. …….

Ne ju kërkojmë të disbursoni shumën e lartpërmendur brenda 45 ditësh nga dita e marrjes së kësaj kërkese në llogarinë bankare që vijon (Banka e eksportuesit italian).

BBAN …….. Çelur në emër të ……Banka : ……Nr. telefoni i zyrës së degës …….. nr. faks i zyrës së degës……

Me respekt,

Datë: …….....

…….....
Nënshkrimi

Me këtë, konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit
…….....
(Banka e eksportuesit italian)

FORMULARI I AUTORIZIMIT TË DISBURSIMIT

SHTOJCA C

Nga: ..... (Banka Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)
Për: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshje financiare prej……. (……) euro, nënshkruar nga …… në..... më..... dhe nga Artigiancassa në .... më .....

Të nderuar zotërinj,

Sipas nenit 8 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, ne do të donim t'ju informonim se kemi marrë dokumentacionin kontraktual duke iu referuar kontratës së furnizimit bashkëlidhur nr. ..... e datës..... midis ..... dhe ..... në lidhje me ..... (programi).

Mbi bazën e reagimit pozitiv dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ne ju autorizojmë të paguani kundërvlerën e dokumenteve përkatëse në favor të.... (Eksportuesi italian).

Me respekt,

Datë: …….....

…….....
Nënshkrimi

FORMULARI I VËRTETIMIT PËR FATURË TË PAGUAR

SHTOJCA D

Nga: Eksportuesi italian
Për: ……. (Bankën Agjente Shqiptare në emër dhe për Huamarrësin)
Për: Artigiancassa S.p.A

VËRTETIM PËR FATURË TË PAGUAR

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr ……..nënshkruar më ..... mes shoqërisë sonë dhe .....…….për furnizimin e ……., ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi marrë shumën prej …… (…. ...) euro si pagesë e pjesshme/totale e kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë lidhet me kredinë e butë prej…… (…. ...) euro, të dhënë nga Artigiancassa, për Qeverinë e ……, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit, 1987, me ndryshimet e pësuara, me anë të Marrëveshjes financiare të nënshkruar në …… më ……..dhe në .....më…….

Për këtë, me anë të kësaj, ne deklarojmë të jemi paguar tërësisht për shumën detyrim sipas kredisë së butë si pagesë për shumën prej .... euro dhe se Huamarrësi, Banka Agjente Shqiptare dhe Artigiancassa nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë e lidhura me shumën e marrë.

Nënshkrimi
…….

Me këtë, konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit.

……
Banka e eksportuesit italian

FORMULARI I NJOHJES SË BORXHIT

SHTOJCA E

…….....(Huamarrësi)

Nr. …….

Vendi dhe data e lëshimit:

……

Referuar Marrëveshjes financiare ndërmjet .....(Huamarrësi), i cili vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë së …….....dhe Artigiancassa-s, e nënshkruar në ……. më ……..dhe në …….. më ……..,..... (Huamarresi) njeh marrjen e shumave që vijojne nga Artigiancassa :

…….....më ……..

…….....më……..

…….....më ……..

Për këtë, ……(Huamarresi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme, të jetë debitor ndaj Artigiancassa, si administratore e Fondit Qarkullues për bashkëpunim e zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave(MEF) të Italisë-me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën principale prej …… (…. ...) euro, të cilën ai merr përsiper ta ripaguajë në ….....(….) këste të barabarta, gjashtëmujore, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar më …… dhe i fundit më …… , sipas grafikut të ripagimit, të caktuar më parë, këtu dhe më poshtë.

Në shumën e veçantë të principalit të kësaj "Njohjeje të borxhit"……(Huamarrësi) merr përsipër të paguajë interesin të cilit i është referuar në grafikun e ripagimit të caktuar më parë dhe këtu e më poshtë, i përllogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare

……(Huamarrësi) do të ripaguajë këstet e pricipalit dhe interesin e parashikuar në këtë "Njohje të borxhit", duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datën e detyrimit, të rënë dakord, në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave të caktuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të.....……, të zhveshur nga çdo tarifë shërbimi e bankës dhe/ose këmbimi.

Nëse zyra e degës në Romë e Artigiancassa S.p.A, për çfarëdolloj arsyeje, duke përfshirë edhe arsye jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin dhe interesin, të parashikuara në "Njohjen e borxhit", Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë zyrës së degës në Romë të Artigiancassa S.p.A, kamatëvonesë mbi këto shuma, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave të caktuar për këtë.

Kjo kamatëvonesë do të përllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë, duke përjashtuar periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh kalendarike, menjëherë vijuese, nga data fillestare e detyrimit dhe më pas, me një normë prej 2,5% (dy pikë pesë për qind) deri në datën e kreditimit ne favor të Artigiancassa-s.

.....

(Sigla e Huamarrësit)

Ky interes i mospagesës së fundit, lidhur me dështimin për të vepruar, do të përditësohet nga autoritetet kompetente italiane; ky përditësim do të ndodhë nga 1 janari 2007.

Artigiancassa S.p.A do të shënojë kohë pas kohe, në këtë "Njohje borxhi", çdo pagesë të principalit dhe të interesit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e listuara ne grafikun e ripagimit, i caktuar më parë dhe këtu e në vijim, kjo "Njohje e borxhit", do t'i kthehet .....(Huamarrësi).

Kjo "Njohje e borxhit" është lëshuar në zbatim të prej …… (….....) euro, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.49 të 26 kredisë së butë shkurtit 1987.

GRAFIKU I RIPAGIMIT

Data e maturimit	Këste principali	Shuma
a) ……	……	……
b) ……	……	……..
c) ……	……	……..
d) ……	……	……..
1) ……	……	……
2) ……	……	……
3) ……	……	……
4) ……	……	……
5) ……	……	……
6) ……	……	……
7) ……	……	……
8) ……	……	……
9) ……	……	……
10) ……	……..	……

…….

(Nënshkrimi i Huamarrësit)